



ДРЖАВЕН ЗАВОД ЗА РЕВИЗИЈА
ENTI SHTETËROR I REVIZIONIT
STATE AUDIT OFFICE

Abstrakti i raportit përfundimtar i revizionit

Subjektet kyçe të përfshira në raportin e revizionit:
Komuna e Butelit

Lënda e revizionit:

Revizioni i raporteve financiare bashkë me revizionin e pajtueshmërisë për vitin 2021_ Llogaria e buxhetit themelore (630)

Qëllimi i revizionit:

Të fitohet bindje e arsyeshme nëse raportet financiare të marra në tërësi janë liruar nga paraqitjet e gabuara materialisht.

Gjendjet kyçe të konstatuara:

- ekzistojnë dobësi gjatë zbatimit të procesit të buxhetimit, janë realizuar rreth 80% nga të ardhurat dhe shpenzimet e planifikuara me Buxhetin e komunës;
- gjatë zbatimit të procedurave për përcaktimin e statusit juridik të objekteve të ndërtuara pa leje nuk dorëzohet raporti vjetor deri te Ministria e Transportit dhe Lidhjes;
- janë konstatuar parregullsi në pjesën e procedurave të lëshimit me qira të hapësirave afariste.

Mendimi i dhënë *:

Është shprehur mendim me rezervë për vërtetësinë dhe objektivitetin e elementeve të raportit financiar Bilanci i të ardhurave dhe shpenzimeve dhe rezultateve të aktiviteteve financiare, si dhe për pajtueshmërinë e transaksioneve dhe aktiviteteve financiare me rregullativën ligjore relevante, udhëzimet dhe politikat e vendosura për vitin 2021.

Rekomandimet kyçe:

- të ndërmerren masa dhe aktivitete për respektimin e afatave të përcaktuara me kalendarin buxhetor;
- të ndërmerren masa dhe aktivitete për vendosjen e regjistrit për pronat e patundshme;
- harmonizimi i Rregullores për kushtet dhe mënyrën e lëshimit me qira të hapësirave afariste në pronësi të komunës me Ligjin për përdorim dhe dispozicion me sendet.

Dobësitë kyçe të sistemit:

Janë konstatuar më shumë gjendje të lidhura me të ardhurat nga arkëtimi i tatimeve komunale, nga dhënia e tokës bujqësore për shfrytëzim në pronësi shtetëror, kompensim për përcaktimin e statusit juridik të objekteve të ndërtuara pa leje, mos harmonizimi i të dhënave në Regjistrin e pronave të patundshme të Qytetit të Shkupit dhe komunave në Republikën e Maqedonisë së Veriut me të dhënat nga sistemi informativ i kadastrës gjeodezike.

Vërejtjet e marra të draft-raportit:

Janë marrë vërejtje për Draft-Raportin nga ana e kryetarit të komunës së Butelit.

Përgjigjet e vërejtjeve të marra:

Pjesërisht është pranuar një vërejtje ndërsa vërejtjet tjerat janë refuzuar.

*



pozitive,



me rezervë



të pavolitshëm



të përmbajtur